

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve /  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Inspektorati Qendror i Punës /  
Central Labour Inspectorate

No./Br./No. 34/2026  
Data/Data/Date 29.01.2026

2



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i  
Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



INSPEKTORATI  
QENDROR I PUNËS

Inspektorët për Marrëdhënie Pune në Inspektoratin Qëndror të Punës, Regjioni në Ferizaj, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] bazuar në dispozitën e nenit 2 dhe 5 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë dhe Ligjit Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/9 të Inspektoratit të Punës në Kosovë, neni 22, 27, 38, 39, të Ligjit për Inspektimet Nr.08/L-067, dispozitën e nenit 2, paragrafi 1, neni 94 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, dispozitën e nenit 97 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 6 i Ligjit Nr.2002/9, për Inspektoratin e Punës në Kosovë i Plotësuar dhe Ndryshuar me nenin 69 të Ligjit Nr.08/L-176, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimi i tyre me Ligjin nr. 05/ L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 29.01.2026 nxjerr këtë:

## V E N D I M

Procedura administrative lidhur me inspektimin në subjektin juridik Esse SHPK me Nui: 810598287, në njësinë Ujë Sharri në Fsh. Bajnicë - Kaçanik, përfundon me njoftimin e këtij akti administrativ.


## A r s y e t i m

Në bazë të planit të punës dhe miratimit të inspektimit Nr.4/2026, datë 08.01.2026 Inspektorët nga Marrëdhënia e Punës [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë zhvilluar inspektim sipas Procesverbalit të datës 22.01.2026, i njëjti me numër zyrtar të protokollit nr. 60/2026 dhe gjatë gjendjes faktike janë evidentuar punonjës të punësuar për të cilët është obliguar punëdhënësi i lartëcekur që të prezantojë dokumentacionin nga lëmia e marrëdhënies së punës duke specifikuar afatin për prezantim dhe është zhvilluar Riinspektim në subjektin e lartëcekur sipas Procesverbalit me datë 28.01.2026 i njëjti i zyrtarizuar me Nr. 85/2026 dhe në mbikqyrje të dispozitave të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, sipas kompetencës së veprimtimit është shqyrtuar dokumentacioni nga lëmia e marrëdhënies së punës, dhe sipas gjendjes faktike gjatë inspektimit dhe riinspektimit nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Andaj me këtë akt administrativ njoftohet subjekti i lartëcekur dhe i njëjti udhëzohet që çdo herë në raport me punonjësit të zbatojë dispozitat ligjore të Ligjit të Punës Nr.03/ L-212.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim është hartuar në katër (4) ekzeplarë identik. Nga një ekzeplar i dorëzohet ndërsa ekzemplarët tjerë mbesin në Inspektoratin Qendror të Punës në Ferizaj për procedurë të mëtutjeshme.

Inspektorët për Marrëdhënie Pune



Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të parashtrojë ankesë Komisionit të ankesave/MFPT-së, organ epror në procedurën e shqyrtimit të ankesave administrative për procedurat e inspektimit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi. Ankesa ushtrohet përmes Inspektorëve të Punës në Ferizaj rruga "Vëllezërit Gërvalla" Administrata Pensionale e Kosovës, kati III.